

Nr 1499 Prot
06/11/2024

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Ndërmjet

UNIVERSITETIT TË ARTEVE

dhe

UNIVERSITETIT POLIS

Neni 1

Palët e Marrëveshjes

Kjo marrëveshje nënshkruhet ndërmjet palëve të mëposhtme:

Universiteti i Arteve, përfaqësuar nga Rektori, Prof. Dr. Erald Bakalli
Adresa: **Sheshi "Nënë Tereza" Nr. 2, Tiranë.**

Dhe

Universiteti Poliss, përfaqësuar nga Rektori, Prof. Dr. Besnik Aliaj,
Adresa: **Rruga Bylis 12, Autostrada Tiranë – Durrës (Km 5) Kashar, Tiranë, Shqipëri.**

Neni 2

Pjesa Hyrëse

Palët në këtë marrëveshje janë organizma/ institucione autonome, të cilat bien dakord të punojnë në partneritet, për arritjen e objektivave të përbashkëta, duke ruajtur identitetet e tyre të ndryshme, qëllimet dhe objektivat e tyre. Me vullnet të lirë e të plotë, palët e mësipërme ranë dakord për hartimin dhe nënshkrimin e kësaj marrëveshje bashkëpunimi (këtu e në vijim do të quhet "*Marrëveshja*") me kushtet e mëposhtme:

Neni 3

Objekti i Marrëveshjes

Objekti i kësaj marrëveshje është forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet Universitetit të Arteve dhe Universitetit POLIS, përcaktimi i prioriteteve themelore të bashkëpunimit dhe i mënyrës së zbatimit të tyre, mbështetur në legjislacionin në fuqi e në parime të gjithë pranuar dhe në interesa të përbashkëta.

Neni 4

Kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje do të zbatohet për të gjithë periudhën duke filluar nga data e nënshkrimit e në vijim.

Marrëveshja rinovohet çdo vit në heshtje dhe zgjidhet vetëm me marrëveshje me shkrim ndërmjet palëve.

Neni 5

Bashkëpunimi i përgjithshëm institucional

Të dyja palët bien dakord që bashkëpunimi në fushat me interes të përbashkët të kryhet në varësi të burimeve, asetëve dhe potencialit të disponueshëm nga secili institucion.

Në nivel institucioni, palët angazhohen që të bashkëpunojnë për:

- Zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta shkencore, si: kuvende, kongrese, konferenca, forume, simpoziume, etj.
- Kryerjen e studimeve të përbashkëta.
- Aplikimin dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta artistike shkencore vendore, rajonale dhe evropiane.
- Nxitjen dhe promovimin e studiuesve të rinj në fushën e artit dhe kulturës.
- Hartimin e strategjive të zhvillimit dhe të akteve normative në zbatim të tyre, në fushën e artit dhe kulturës.
- Shkëmbimet reciproke të pedagogëve dhe studentëve sipas programeve të studimit.

Neni 6

Bashkëpunime të veçanta

- Anëtarë të njërive bazë, njërive kryesore dhe anëtarë të Senatit Akademik të dy institucioneve marrin pjesë në aktivitete me interes të përbashkët, në zgjerim të traditave të mirënjohura të bashkëpunimit, siç parashikohet në Ligj dhe në Statutin përkatës të institucionit.
- Institucionet garantojnë përfshirjen e ekspertëve sipas fushave në njësitë e reja të kërkimit artistik shkencor ngritur pranë tyre. Institucionet rekomandojnë e propozojnë përfshirjen e ekspertëve më cilësorë, ato bashkëpunojnë në drejtimin e realizimit të veprimtarisë së tyre.
- Institucionet ftojnë përfaqësues të tyre të marrin pjesë si anëtarë jurie, vlerësues të jashtëm, recensues dhe oponentë në organizimin dhe zhvillimin e konkurseve shkencore për çmimet kombëtare vjetore të shpallura prej tyre, në të gjitha fazat e tyre.
- Përfaqësues nga të dy institucionet marrin pjesë në mënyrë reciproke në organizma, ose struktura që funksionojnë pranë këtyre institucioneve, sipas një marrëveshjeje paraprake dhe akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- Palët ofrohen për bashkëpunim për hartimin e programeve të veçanta të studimeve universitare për ciklin e dytë të studimit master dhe ciklin e tretë të studimit doktoratë, si dhe për drejtimin shkencor të tyre.
- Palët mundësojnë zhvillimin e praktikave mësimore të studentëve pranë njërive të tyre sipas fushave të studimit.

Neni 7 Njoftimet dhe komunikimet ndërmjet palëve

Palët angazhohen të mbajnë linja të hapura komunikimi në të gjitha nivelet dhe të shkëmbejnë çdo informacion të nevojshëm që lidhet me veprimtarinë e tyre.

Çdo njoftim dhe komunikim mes palëve për këtë Marrëveshje, duhet të jetë në formë të shkruar. Komunikimet për efekt të kësaj marrëveshjeje, do të kryhen drejtpërdrejt me personin e kontaktit për Departamentin “Art dhe Dizajn”.

Çdo njoftim dhe komunikim, duhet të dërgohet personalisht, me postë ose me postë elektronike në adresat/kontaktet e mëposhtme:

Person kontakti për Universitetin e Arteve	Person kontakti për Departamentin e Art dhe Dizajn
Shqipëri, Sheshi “Nënë Tereza” Nr. 2, Tiranë.	Shqipëri, Tiranë, Rr. “Bylis 12”, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 5, Kashar.
Përfaqësues: Dr. Ermir Hoxha	Përgjegjëse Departamenti: Dr. Sonia Jojic
Email: ermirhoxha@yahoo.com	Email: sonia_jojic@universitetipolis.edu.al
Cel: +355 68 604 7899	Tel: +355 4 2407420 / +355 4 2407421 Fax: +355 4 2407422

Neni 8 Ndryshime, Amendime, Revokime, Zgjidhje të mosmarrëveshjeve

Çdo pikë e marrëveshjes mund të ndryshohet, mendohet ose revokohet në çdo kohë, pas një konsultimi dhe mirëkuptimi reciprok ndërmjet dy institucioneve.

Çdo ndryshim i kësaj marrëveshjeje do të aprovohet me shkrim nga palët. Specifikimet dhe ndryshimet në këtë marrëveshje rregullohen me anë të anekseve të cilat bëhen pjesë e kësaj marrëveshjeje pasi siglohen nga të dyja palët.

Në raste të mosmarrëveshjeve, palët i zgjidhin ato me mirëkuptim nëpërmjet negocimit.

Neni 9 Hyrja në fuqi dhe përfundimi i Marrëveshjes

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.

Kjo Marrëveshje hartohet në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe, nga një kopje për secilën palë, e cila nënshkruhet me vullnet të lirë nga të dyja palët, pasi është lexuar e kuptuar me qartësi.

Palët kanë të drejtë të formulojnë e nënshkruajnë marrëveshje të veçanta bashkëpunimi dhe partneriteti, për çdo veprimtari konkrete që përputhet me frymën e kësaj marrëveshjeje.

Nënshkruar në Tiranë, më 06/11/2024

UNIVERSITETI I ARTEVE

REKTORI
Prof. Dr. Erald Bakalli



UNIVERSITETI POLIS

REKTORI
Prof. Dr. Besnik Aliaj

